

Mr. Talha Kurtishi

Reagim ndaj shkrimit në gazetën Koha e botuar me 7 gusht 2015 në faqën e pestë dhe me nëntitull: **“Hoxhallarët e Listës së zezë të BFIM-së dhe policisë”**.

Lidhur me përmendjen e emrit tim (edhe pse në formë të deformuar) unë Talha Kurtishi deklaroj si më poshtë:

Ska dyshim se gazetaria e mirëfilltë është nevojë shoqërore por jo edhe atëherë kur bëhet vegël e dezinformimit dhe stigmatizimit. Ju si gazetë me veprimet e këtilla arbitrare si dhe me qasjen tuaj joprofesionale jeni vendosur në pozitë të shërbëtorit të një fushate të mjegullimit të hapsirës publike me akuza të pabaza në adresën e fajtorit kujdestar.

Unë si hoxhë i cili domosdosmërisht i përhap mësimet e fesë nuk lejoj e as që pranoj të stigmatizohem në mënyrën si keni vepruar ju. Bekgrundi im sa i përket arsimimit fetar dhe jofetar është i pastër dhe unë qëndroj pas tij në gjitha format. Unë e predikoj islamin ashtu siç e kam mësuar si fe e mesatarisë që vendos balansin e përkryer mes nevojave materiale dhe ato shpirtërore.

Qëndrimet e mia janë publike dhe në asnjë mënyrë nuk reflektojnë e as që përçojnë ndonjë mesazh radikalizues. Islami feja të cilës i përkas nuk radikalizon përkundrazi ajo fisnikëron dhe i ngjall vlerat pozitive të çdo musliman.

Qëndrimi im ndaj BFI-së gjithnjë ka qenë dhe vazhdon të jetë konstruktiv. Unë besoj se roli që e ka kjo bashkësi është rol kyç për mbarëvajtjen e jetës fetare në Maqedoni. Respektimi i këtij institucioni vazhdon të jetë motoja e veprimtarisë sime dhe këtë e kam vërtetuar edhe në kontaktet e mia të vazhdueshme që i kam me këtë institucion. Prandaj nuk lejoj që dikush për agjendat e tyre të më vendos përball BFI-së antëtar i së cilës jam.

Sa u përket institucioneve shtetërore ju përkujtoj se baza e bashkëjetesës dhe progresit janë drejtësia. Aty ku drejtësia është selektive dhe përjashtuese për disa shtresa të shoqërisë vendi nuk e ka marr drejtmin e duhur dhe ec në rrugë të gabuar.

Jam i vetëdijshëm se përmendja e emrit tim nuk është e rastësishme. Ajo në vete ngërthen mesazhe dhe porosi por kjo nuk më tremb ngase e di se jam bartës i mesazheve të Islamit për të cilin vetë Kurani famëlartë thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”** (El Enbija, 107)

Muhamedi, sal-lallahu alejhi ue selem, u dërgua me shpalljen e fundit që është mëshirë për botët dhe si e tillë assesi nuk mundet me qenë radikalizuese dhe terrorizuese. Hasha.

Koha
 E përditshme informative
 1000 - 8 mars 2015 - 8 pageshë Tiranë 2015



Sulmi në tru,
 ja menyja që
 ju shpëton



Shtatori pa shkollat e premtuara

Shkollat e shtatorit do të jenë të shkurtra për shkak të ditës së shtatorit të ri. Kjo do të thotë se shkollat do të hapen më vonë se zakonisht. Një numër i shkollave do të jenë të mbyllura për shkak të ditës së shtatorit të ri.

Aktori i zgjoruar politik kundër radikalizimit islamik

Nëntë të arrestuar, kërkohen edhe 27



SPECIAL

Të jetosh në pesë vendet më të lumtura të botës



Shën, ndërkohë që...
 Të jetosh në...
 pesë vendet...
 më të lumtura...
 të botës...

**FILLOJ
 Rusia ka**

-DEMANDANT